
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SUHAREKES THE MUNICIPALITY SUHAREKË OPSTINE SUVA REKA	
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT 05 NR. _____ Datë : 09.07.2024		<div style="text-align: right; font-size: 2em; font-weight: bold; margin-bottom: 10px;">09 07 24</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; display: flex; justify-content: space-between;"> 05 MM 36732 7 </div>

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversital në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, :Ligjin për Arsim dhe aftësim profesional nr.04L-138 dhe Udhëzimin administrativ Nr.22/2013, numri maksimal i nxënësve në klasa dhe raporti mësimdhënës-nxënës si dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), të caktuara nga MASHT, Drejtoria komunale e Arsimit-Suharekë shpall

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe IAAP në vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- **Dëftesën** origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- **Ekstraktin e lindjes.**

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën 10, 11 dhe 12 korrik 2024, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 13.07.2024.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 15.07.2024.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

SUHAREKË

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.		
Suharekë	"Skender Luarasi"	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Teknik i informatikes se bizneseve	1	24		
			Teknik per dizajnim te mediave interaktive	1	24		
		Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Instalues elektrik	1	24		
			Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit	1	24		
			Automekanik	1	24		
			Mekatronikë	1	24		
			Arkitekturë	1	24		
		Art	Rrobaqepsi	1	24		
			Dizajn enterieri	1	24		
			Dizaj i tekstilit dhe veshjeve	1	24		
	Gjithsej: S. Luarasi				10	240	
	"Abdyl Ramaj" Shirokë	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Laborant i kimisë	1	20		
			Teknologji e materialeve dërtimore	1	20		
		Ekonomi, administim dhe juridik	Kontabilist	1	20		
			Banka dhe sigurime	1	20		
			Tregti me shumicë dhe pakicë/dual	1	20		
			Asistent juridik	1	20		
		Shërbime	Asistent i mikëpritjes hoteliere/dual	1	20		
		Agrokulturë, pylltari, peshkatori dhe veterinari	Pemëtari-vreshtari	1	20		
			Teknologji ushqimore	1	20		
		Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkepunetor profesional i infermierisë	1	24		
			Asistent dentar	1	24		
		Gjithsej: A. Ramaj				11	228
		"Jeta e re"		Shkenca natyrore	5	110	
	Shkenca shoqërore dhe gjuhësore			4	88		
	Gjithsej: "Jeta e re"				9	198	
	Gjithsej: Suharekë				30	666	

Drejtori i DKA-së-Suharekë
Remzi Bajselmani

